

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (5) dhe nenin 29 të Ligjit për media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13 dhe 13/14 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.63/24 dhe 74/24), pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprimin sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10 -2754/1 datë 13.06.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3053/3 datë 18.07.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 29-të mbajtur më 17.07.2024, miratoi si në vijim:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, për shkelje të kryer nga neni 15 paragrafi (5) të Ligjit për Media (LM), në mënyrë që në afatin e parashikuar ligjor (31 mars 2024) nuk i dorëzoi Agjencisë raport me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim në radio, nr.08-95 datë 07.09.2023.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-2754/1 datë 13.06.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe nenit 29 të LM, është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të veprimtarisë së botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të veprimtarisë së tyre me detyrimet e neneve 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë vërejtje publike në rastet kur është konstatuar mosrespektim, shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara nga Ligji i njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në nenin 29 paragrafi (2) të LM, parashihet se masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen përkatësisht edhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 15 paragrafi (5) të LM, transmetuesit janë të detyruar që trupit rregullator kompetent t'i paraqesin raport me shkrim, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv ose radio, dhe veçanërisht për realizimin e konceptit programor, jo më vonë se data 31 mars i vitit aktual. Si shtojcë e raportit dorëzohen edhe informata për mjetet teknike përmes së cilit transmetohet ose ritransmetohet shërbimi i tyre programor në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë vendit. Raporti me shkrim dorëzohet në formularin e përcaktuar nga trupi rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 13 qershor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative, gjatë së cilës është konstatuar se SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar në afatin e parashikuar ligjor (31 mars 2024) nuk i ka dorëzuar Agjencisë raport me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim në radio, veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, as informacion për mjetet teknike përmes së cilës transmetohet ose ritransmetohet

shërbimi programor në vend ose jashtë vendit, pra nuk i përmbush detyrimet nga neni 15 paragrafi (5) nga LM.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-2754/1 datë 13.06.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar me datë 14.06.2024, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-2754/2 datë 14.06.2024, dhe i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-2754/1 datë 13.06.2024, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. E njëjta më 17.06.2024 dhe më 03.07.2024, është dorëzuar në formë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit regjistruar si informacion kontaktues në RQRMV dhe në regjistrin e transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt më 03.07.2024. Në afatin e parashikur, SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar nuk u deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 17.07.2024, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim ka konstatuar që SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar t'i shqiptohet masë - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (5) dhe neni 29 i LM, pikat 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-2754/1 datë 13.06.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3053/3 datë 18.07.2024, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 29-të mbajtur më 17.07.2024, ka miratuar Aktvendim me të cilin paralajmëron SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar dhe urdhëron që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij botuesi i medias (transmetuesi) ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark. nr.10-2754/1 datë 13.06.2024.